

VENDIM
Nr.107, datë 10.2.2010

PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR¹

(Ndryshuar me VKM nr.212, datë 16.3.2011; nr.707, datë 26.6.2015; nr.432, datë 11.7.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të *ministrit përgjegjës për arsimin*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Ministria përgjegjëse për arsimin* miraton dhe certifikon tekstet shkollore të arimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të *ministrit përgjegjës për arsimin*.

2. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e *ministrit përgjegjës për arsimin*. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara në shkollë ose DAR/ZA, për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese.

2/1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) dhe shtëpi të tjera botuese ngarkohen me botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të pakicave kombëtare, të klasave I deri IX, dhe të teksteve të arimit profesional. Shtypja e këtyre teksteve të realizohet në SHBLU dhe në shtypshkronja të tjera.

Çmimi i këtyre teksteve miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin. Mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohet me udhëzim të ministri përgjegjës për arsimin.

3. Tekstet shkollore shpërndahen/shiten në mjediset shkollore. Drejtoritë e shkollave ofrojnë një ose dy mjedise shkollore, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në shkollën në fjalë.

4. Çmimi i shitjes është ai i vendosur në kopertinën e tekstit shkollor të certifikuar. Çmimet e teksteve shkollore, të miratuara nga *ministria përgjegjëse për arsimin*, indeksohen çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, të publikuar nga INSTAT.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë, të certifikimit, të *ministrisë përgjegjëse për arsimin*.

¹ VKM nr. 107, datë 10.2.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, datë 19 mars 2010.

VKM nr.212, datë 16.3.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, datë 17 prill 2011.

VKM nr. 707, datë 26.6.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.154, datë 2 shtator 2015.

VKM nr.432, datë 11.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.105, datë 17 korrik 2018.

Pulla me hologramë u shitet botuesve nga *ministria përgjegjëse për arsimin*, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, janë si më poshtë vijon:

6.1 për nxënësit në arsimin parauniversitar që:

a) gëzojnë statusin ligjor të jetimit;

b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;

c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-së), sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti;

d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i *ministrisë përgjegjëse për arsimin* në formën e “Transfertës tek individët”, në masën 100 për qind të tij.

6.2 Për nxënësit në arsimin 9-vjeçar, që vijnë nga familje ku kryefamiljari është i punësuar në institucionet publike buxhetore dhe jobuxhetore të pushtetit qendror apo vendor, si dhe në shoqëritë me kapital shtetëror, me pagë mujore bruto deri 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat, çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i vetë institucionit apo shoqërisë, në masën 50 për qind të tij.

6.3 Këshilli i Ministrave u rekomandon të gjithë punëdhënësve privatë të mbështesin financiarisht kompensimin e teksteve shkollore për të gjithë punëmarrësit e tyre, që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë pagë mesatare mujore deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj. Kjo pagesë njihet si shpenzim i veprimtarisë për efekte fiskale.

6.4 Për tekstet shkollore të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, dhe për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çmimi i blerjes të mbulohet në masën 100 për qind, me fondet e *ministrisë përgjegjëse për arsimin*.

6.5. Për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedura e blerjes së tyre realizohet nga *ministrisë përgjegjëse për arsimin*, kundrejt procedurave të konkurrimit të hapur me shtëpitë botuese. Procesi i botimit, i shtypjes, i shpërndarjes dhe i shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese.

6.6. *Ministria përgjegjëse për financat*, në bashkëpunim me selitë diplomatike në këto vende, dërgon në ministrinë përgjegjëse për arsimin, brenda muajit maj të çdo viti, kërkesën për tekste shkollore, të detajuar sipas grup-moshave të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ministria përgjegjëse për arsimin dërgon në ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit gusht të çdo viti, sasinë e teksteve shkollore të porositura.

6.7. Për tekstet shkollore të fëmijëve romë, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së

tyre të mbulohet 100% nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës romë, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

6.8. Nxënësit që gëzojnë statusin e të verbrit, të cilët mësojnë në klasat I deri IX, pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin brail, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar. Çmimi i blerjes së këtyre teksteve të mbulohet 100% nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Këto tekste shkollore janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre mund të variojë nga dy deri në tre vjet.

6.9. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore të arsimit bazë mbulohet në masën 100% nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin:

a) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktima të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.

Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit në përputhje me vendimin nr. 582, datë 27.7.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit”.

b) Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit /vuajtjes së dënimit.

c) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.

ç) Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.

d) Për çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.

6.10. Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

6.11. Për tekstet shkollore të fëmijëve nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

6.12 Nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt u

jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Institucionet arsimore, si dhe njësitë arsimore vendore, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt.

Blerja e teksteve shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor, për llogari të njësisë arsimore vendore.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj subjekteve, shtëpive botuese, realizohet nga njësia arsimore vendore, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët”, në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit.

Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Shitja e teksteve shkollore bëhet përkundrejt faturave. Për kategoritë e nxënësve, që përfitojnë sipas pikës 6 të këtij vendimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të DARZA-ve ose të vetë shkollës, kur ka llogari të tillë, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët” në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

8. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore, për blerjen e teksteve shkollore, si dhe mënyra e pagesës për kategorinë e nxënësve përfitues, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

8/1. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në brail dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohen nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në DARZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.

9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimi nr.260, datë 18.4.2007 i Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha